

NDËRVEPRIMI NË MES TË MIRËQENIES PSIKOLOGJIKE, STRESIT,  
ANKTHIT DHE PLANIFIKIMIT TË SHTATZANISË TEK NËNAT QË KANË  
FËMIJË ME AUTIZËM

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I ARTEVE NË DREJTIMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE  
KËSHILLIM  
NGA  
PUKJANA GECI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM  
PRISHTINË

PRISHTINË, 2023

## REZYME

### NDËRVEPRIMI NË MES TË MIRËQENIES PSIKOLOGJIKE, STRESIT, ANKTHIT DHE PLANIFIKIMIT TË SHTATZANISË TEK NËNAT QË KANË FËMIJË ME AUTIZËM

Kandidatja: Pukjana Geci

Mentori: Prof. Ass. Dr. Liridona Jemini Gashi

Qëllimi i këtij studimi është të fitojë informacion rreth ndërveprimit e mirëqenies psikologjike, ankthit dhe stresit tek nënat që kanë fëmijë me autizem. Veçanërisht të përcaktojë nëse ka ndërlidhje në mes mirëqenies psikologjike, ankthit dhe stresit dhe nëse këto variabla ndikojnë në planifikimin e shtatzanisë tek nënat që kanë fëmijë me autizëm. Punimi është i përmbledhur në 75 faqe, brenda të cilave përfshihen shtojcat dhe burimet shkencore (literatura). Sipas formatit për punimin e temës së diplomës, i gjithë punimi është ndarë në 4 kapituj kryesorë.

**Kapitulli I:** Ky kapitull përmban pjesën hyrëse (përmbajtjesore) të punimit, shqyrtimin e literaturës, kontekstin e studimit, kornizën teorike, arsyetimin e studimit, rëndësinë e studimit, hipotezat dhe pyetjet kërkimore.

Pyetjet kërkimore të studimit janë:

1. A ekziston ndërlidhje në mes mirëqenies psikologjike dhe stresit tek nënat që kanë fëmijë me autizëm?
2. A ekziston ndërlidhje në mes mirëqenies psikologjike dhe ankthit tek nënat që kanë fëmijë me autizëm?
3. Si ndikon stresi dhe ankthi në planifikimin e shtatzanisë tek nënat që kanë fëmijë me autizëm?
4. A e parashikon mirëqenia psikologjike, planifikimin e shtatzanisë dhe perballimin e stresit dhe ankthit tek nënat që kanë fëmijë me autizëm?

Hipotezat e hulumtimit janë si vijon:

- H1: Ekziston një lidhje negative midis nivelit të mirëqenies psikologjike, dhe stresit tek nënat që kanë fëmijë me autizëm.
- H2: Ekziston një lidhje negative midis nivelit të mirëqenies psikologjike, dhe ankthit tek nënat që kanë fëmijë me autizëm
- H3: Niveli i lartë i stresit dhe ankthit ndikon negativisht në planifikimin e shtatzanisë

- H4: Niveli i lartë i mirëqenies psikologjike do të ketë ndikim pozitiv në planifikimin e shtatzanisë dhe në përballimin e stresit dhe ankthit të lidhur me autizmin e fëmijëve të tyre.

**Kapitulli II:** Në pjesën e metodologjisë përshkruhen atributet e pjesëmarrësve të këtij hulumtimi, shpjgohet mënyra e mostrimit, metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit, instrumentet matëse, procedura e realizimit të studimit dhe mbledhjes së të dhënave, dizajni i studimit si dhe analizat statistikore të përdorura për tu dhënë përgjigje eventuale hipotezave. Ashtu siç shpjgohet edhe në pjesën e metodologjisë së punimit, pjesë e mostrës së përdorur për studim, ishin 40 nëna që kishin fëmijë të diagnostifikuar me autizem. Për të mbledhur të dhëna në lidhje më nivelin mirqënies psikologjike të nënave është përdorur version i veçantë për mirqënien psikologjike: *Psychological Well-Being Scale (PWBS; Ryff, 1989)* ndërsa për matjen e stresit prindëror është përdorur: *Indeksi i Stresit Prindëror PSI-SF (Richard, 1995)*. Për matjen e ankthit tek nënat është përdorur: *Instumeti matës i ankthit (Charles. et al, 1973)*. Procedura për mostrim ishte e qëllimshme dhe u përdor dizajni korrelacional predikues cili shërbeu për të parë ndërlidhjen mes variablave të studimit si dhe mënyrën së si ato parashikojnë njëra-tjetrën. Është përdorur dhe regresionin për të parë ndikimin e variablave të studimit.

**Kapitulli III:** Në kuadër të pjesës së kapitullit të rezultateve, përshkruhen karakteristikat e studimit dhe analizat statistikore të realizuara për të analizuar dhe për t'i interpretuar të gjeturat e studimit:

Rezultatet tregojnë së:

- Mirëqenia psikologjike: Ka një korelacion negativ të moderuar me stresin prindëror (-0.651), distresin e prinderimit (-0.615), disfunksionin e marrëdhënies prind-fëmijë (-0.582) dhe fëmijërinë e vështirë (-0.583). Të gjitha këto korelacione janë statistikisht të rëndësishme ( $p < 0.001$ ) me ç'rast me uljen e nivelit të mirëqenjes psikologjike rritet stresi prindëror.
- Mirëqenia psikologjike: Ka një korelacion negativ të moderuar me ankthin (-0.649). Ky korelacion është statistikisht i rëndësishëm ( $p < 0.001$ ). Këto rezultate tregojnë se mirëqenia psikologjike është ndërlidhur negativisht me nivelet e ankthit.

Kjo sugjeron se sa më tepër të rritet mirëqenia psikologjike, aq më ulët është niveli i ankthit.

- Stresi prindëror ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm në nivelin e planifikimit të shtatëzani të re. Vlera e koeficientit të stresit prindëror.  $-0.006$  e cila tregon se një rritje e një standard devijimi në stress prindëror shoqërohet me ulje prej  $0.006$  në nivelin e planifikimit të shtatëzani të re.
- Ankthi: Nën timer që planifikojnë shtatëzani të re kanë një mesatare më të ulët të ankthit (Mean = 23.8571) krahasuar me ato që nuk planifikojnë shtatëzani të re (Mean = 36.5938). Dallimi midis tyre është statistikisht i rëndësishëm ( $t = -2.449$ ,  $p = 0.019$ ).
- Mirëqenia psikologjike ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm në nivelin e planifikimit të shtatëzani të re. Vlera e koeficientit të mirëqenies psikologjike është  $0.006$  e cila tregon se një rritje e një standard devijimi në mirëqenie psikologjike shoqërohet me rritje prej  $0.006$  në nivelin e planifikimit të shtatëzani të re. Rezultatet e regresionit tregojnë se 11.7% e variacionit në nivelin e planifikimit të shtatëzani të re mund të shpjegohet nga variacioni në mirëqenie psikologjike . Nën timer që planifikojnë shtatëzani të re kanë një mesatare më të lartë të mirëqenies psikologjike (Mean = 171.00) krahasuar me ato që nuk planifikojnë shtatëzani të re (Mean = 147.37). Dallimi midis tyre është statistikisht i rëndësishëm ( $t = 2.37$ ,  $p = 0.023$ ).

**Kapitulli IV:** Shënon kapitullin e fundit të studimit, përmban të gjeturat në mënyrë të përmbledhur duke ripotencuar dhe diskutuar të gjeturat në mbështetje të literaturës së parashqyrtuar, po ashtu duke prezantuar kufizimet shkencore të hulumtimit, të mbështetura me rekomandime konkrete për hulumtimet e radhës.

**Konkluzion:** Mbi bazën e analizave të objektivave të këtij studimi, mund të konkludohet se rezultatet kanë dhënë përgjigje për pyetjeve hulumtuese dhe kanë mbështetur supozimin kryesorë të këtij studimi sipas të cilit ekziston ndërlidhje negative në mes mirëqenies psikologjike, stresit, ankthit dhe planifikimit të shtatëzani të re tek nënat që kanë fëmijë me autizem. Rezultatet e këtij studimi mund të jenë kontribuese për studimet me qëllime të përafërta. dhe diskutimit të gjetjeve të tyre. Mbështetur në të gjitha statet dhe karakteristikat e studimit, veçanërisht në rezultate, është e sugjerueshme mundësia për studime të tjera për këtë fushë.